

RELACION ARKITEKTONIK

PROJEKT:

“Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë”

Mobilimi

Faza: Projekt zbatimi

Hartoi:

ARCHISPACE + iRI

2025

Përmbajtje

HYRJE

3 - 5

- 1. Qellimi i projektit
- 2. Mobilimi

HAPËSIRAT

6 - 11

- 1. Kati Përdhe
- 2. Kati i parë

MOBILJET

12 - 15

1. QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit është krijimi i një qendre moderne dhe multifunktionale që fokusohet në kërkimin, zhvillimin dhe eksperimentimin e produkteve dhe shërbimeve të reja në fushën e ndërtimit, teknologjisë dhe projektimit. Kjo qendër do të veprojë si një inkubator që trajton probleme reale të komunitetit dhe teston zgjidhje në ambiente autentike, duke u mundësuar studiuesve dhe profesionistëve të kuptojnë më mirë sfidat dhe të zhvillojnë zgjidhje të përshtatshme.

Objektivat kryesore të ndërhyrjes janë:

1. Rehabilitimi i ish-objektit të ISTN dhe i zonës përreth, duke e transformuar në një hapësirë funksionale për inovacion në ndërtim dhe dizajn.
 2. Krijimi i një qendre kërkimore dhe projektimi që promovon bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm në fusha si zhvillimi urban, teknologjia dhe aspektet sociale.
 3. Zhvillimi i hapësirave për testim dhe prototipim, ku do të eksperimentohen ide të reja dhe zgjidhje për probleme konkrete, me qëllim gjenerimin e parimeve të reja për teknologjitë ndërtimore.
 4. Trajnimi i brezave të rinj, duke i pajisur ata me njohuri bashkëkohore në projektim, ndërtim dhe teknologji përmes metodave të avancuara të të mësuarit.
- Qasja që kërkohet është gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme, duke përdorur asetet hapësinore, njerëzore, teknologjike dhe akademike për të fuqizuar komunitetin profesional përballë sfidave të kohës.

Struktura funksionale e ndërtesës do të ndahet në disa zona kryesore:

- Zona e Projektimit: Hapësira për zhvillimin e ideve, maketeve dhe modeleve përmes printimit dhe skanimit 3D, si dhe provave reale të sistemeve hapësinore.
- Zona e Eventeve: Sallë shumëfunktionale për takime, prezantime, ekspozita dhe eksperimente me realitet virtual. E pajisur me projektorë, sensorë dhe teknologji për ndërveprim digjital.
- Zona e Administratës: E organizuar në tre kate, përfshin zyrat, hapësirat e punës, shërbimet mbështetëse dhe zona të rekreacionit për stafin. Një pjesë ndërtohet mbi taracën ekzistuese.
- Zonat Rekreative dhe të Shërbimeve: Hapësira për pushim, mensë dhe ambiente ndihmëse që shpërndahen në ndërtesën kryesore dhe në një objekt njëkatësh përballë, përfshirë dhe shfrytëzimin e

taracës si hapësirë pushimi.

- Zona e Laboratorëve SMART: Dedikuar zhvillimit të sistemeve të mençura për menaxhimin e ndërtesave dhe qyteteve (eficienca energjetike, ndriçimi, kontrolli i aksesit, menaxhimi i të dhënave). Përfshin hapësira projektimi, prova dhe takime.
- Arkiva dhe Serverët: Hapësira për arkivimin fizik dhe dixhital të të dhënave, përfshirë edhe funksionalitetet për dixhitalizim dhe përdorimin e algoritmeve të inteligjencës artificiale në analizë dhe vendimmarrje.
- Zona e Kontrollit: Për monitorimin e sistemeve të brendshme të ndërtesës, kantierëve ndërtimorë dhe elementëve të jashtëm si trafiku apo lëvizjet urbane, duke grumbulluar të dhëna në kohë reale.
- Laboratori i Hapur: Ambient për prova në natyrë me materiale dhe pajisje ndërtimore, testim të automatizimit dhe makineri ndërtimi në kushte reale, me depo për materiale dhe vegla në një ndërtesë ngjitur.
- Zona e Ekspozitës së Materialeve: Hapësirë për promovimin dhe prezantimin e materialeve ndërtimore dhe teknologjive të reja, që nxit bashkëpunimin mes kompanive, profesionistëve dhe studentëve të fushës.

Objekti konkret i punës së projektimit fokusohet në pikat si më poshtë:

1. Analize të situatës aktuale dhe termave të referencës
2. Analize teknike të objektit dhe strukturës ekzistuese
3. Projekt ide paraprake për objektin dhe hapësirat funksionale
4. Projektin teknik dhe shtimin e hapësirave të nevojshme për mirë funksionimin e objektit
5. Raporti i Vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr.10440, datë 07.07.2011, VKM 686 29.07.2015 dhe akteve nënligjore përkatëse
6. Raporti Teknik
7. Topografia e zonës
8. Projekti Konstruktiv
9. Projekti Hidro-mekanik
10. Projekti Elektrik
11. Specifikimet teknike përkatëse
12. Grafiket e punimeve
13. Preventiv
14. Liste e pajisjeve të nevojshme për funksionimin e hapësirave

Një element thelbësor i projektit është edukimi dhe formimi profesional për brezin e ri. Do të krijohen hapësira të posaçme për trajnime mbi teknologjitë më të fundit në ndërtim, projektim dhe menaxhim të zgjidhjeve të qëndrueshme, duke i ndihmuar të rinjtë të eksperimentojnë dhe të ndërtojnë prototipe reale.

Për zbatimin e projektit do të përfshihen ekspertë nga disiplina të ndryshme – përfshirë inxhinierë të ndërtimit, elektronikës, mjedisit dhe IT-së – të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin e sistemeve inteligjente, përmirësimin e eficiencës energjetike dhe menaxhimin e mbetjeve ndërtimore në mënyrë të qëndrueshme.

Në përfundim, ky inkubator synon të krijojë një platformë gjithëpërfshirëse për inovacion në ndërtim dhe urbanistikë, duke kthyer Tiranën në një pikë referimi për zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive të reja në fushën e arkitekturës dhe ndërtimit.

2. MOBILIMI

Mobilimi i objektit synon të përforcojë funksionalitetin e hapësirave. Ai është realizuar duke pasur parasysh përshtatshmërinë në përdorim. Shumë prej mobiljeve janë të çmontueshme nga vetë përdoruesit, për të garantuar shfrytëzimin maksimal të hapësirës dhe për të nxitur ndërveprimin mes hapësirave dhe programeve të ndryshme që ato mbartin.

Mobiljet synojnë të funksionojnë si zgjatim i ambienteve dhe si mjete arkitektonike, në rolin e filtrit ndërmjet hapësirave. Shumë prej tyre janë transparente për të theksuar komunikimin vizual mes përdoruesve, ndërsa të tjera janë të pajisura me mekanizma që mundësojnë montimin dhe çmontimin, duke mos lejuar që ato të shndërrohen në elementë të ngurtë hapësinorë.

Projektimi i mobiljeve është kryer duke pasur tre objektiva në fokus:

A. PËRSHTATSHMËRIA

Mobiljet synojnë të jenë të adaptueshme dhe të redaktueshme sipas kontekstit të përdorimit. Këto lloj mobiljesh gjenden kryesisht në zonat me karakter publik, aty ku përqendrohen edhe funksione të shumta. Panelet e ekspozimit në hollin e katit përdhe, tavolina e punës në sallën Fab Lab, etj., janë disa prej shembujve përfaqësues të kësaj qasjeje.

B. KOMUNITETI SI NDËRTUES

Pajisja me mjetet e nevojshme dhe hapësira për punë mundëson që komuniteti të bëhet pjesë aktive e krijimit të mobiljeve. Disa prej tyre mund të ndërtohen në vend nga internët, studentët apo individë të interesuar në këtë proces. Kjo realizohet përmes workshop-eve të mobilimit, duke sjellë një përfitim të dyfishtë. Një qasje e tillë rrit përfshirjen e përdoruesit, duke i dhënë atij një lidhje më të fortë me hapësirën përreth.

C. MOBILJET SI ZGJATIM I PROJEKTIT

Mobiljet janë konceptuar si vazhdimësi e ideve projektuese. Ato janë modulare dhe përshtaten sipas skenarëve të përdorimit. Modulariteti i tyre i ngjan një qyteti me një strukturë bazë të pandryshueshme, e cila i përshtatet nevojave të përdoruesve dhe ndryshon sipas tyre.



FIG.1 FRAGMENT MOBILIMI. IMAZH.

Hapësirat

1. KATIO




FIG.2 PLANIMETRIA E KATIT 0

1.1 HYRJE+RECEPSION

Kjo zonë mbart karakterin më publik të objektit, duke shërbyer si vatër shpërndarëse për në sallën e eventeve dhe si hapësirë pritjeje për ambientet e studios së projektimit, administratës dhe laboratorit. Karakterizohet në mobilim nga raftet me sistem ekspozimi fleksibël që veshin pjesën më të madhe të mureve dhe tavolinat gjatësore të ekspozimit që organizojnë drejtimin e lëvizjes në holl dhe ofrojnë hapësirë magazinimi me akses publik, në formën e broshurave ose fletushkave informuese.



FIG.3 FRAGMENT I HYRJES. IMAZH.

1.2 STUDIO PROJEKTIMI

Studioja e projektimit është e orientuar t'u shërbejë profesionistëve të rinj të fushës, duke u sjellë në të njëjtën kohë si vend praktike për ta. Organizimi planimetrik është në formën “open-space” dhe brenda gjendet hapësira e punës, mbledhjes dhe rekreacionit. Rafte që shkojnë deri në tavan ofrojnë hapësirë magazinimi dhe rafte të ulëta transparente sillen si hapësira filtër për nën-programin që studioja e projektimit mban. Ajo ka akses të drejtpërdrejtë me sallën e eventeve.

1.3 VR DHE SALLË EVENTESH

Duke qenë se përdoret për qëllime të shumëfishta hapësira është e lirë dhe mobilimi është fleksibël. Karakterizohet nga paretet e lëvizshme në perimetër të mureve dhe nga karriget që vendosen njëra-mbi tjetrën duke e hapur ose mbushur sallën në varësi të eventit që organizohet. Shoqërohet me perde të cilat e mbyllin sallën, duke i dhënë izolim të mirë akustik. Projektoret tavanorë mundësojnë një eksperiencë virtuale më gjithëpërfshirëse.

1.4 LABORATORI I TEKNOLOGJISË SË NDËRTIMIT FAB LAB

FabLab-i do të funksionojë si gjenerator i zgjidhjeve praktike për ide të ndryshme, duke krijuar mundësinë për testimin e produkteve, simulimin e situatave të caktuara dhe përkthimin e koncepteve në formë të prekshme. Kjo hapësirë duhet të ofrojë mjedis të mjaftueshëm për zhvillimin dhe verifikimin paraprak të ideve, përpara se ato të kalojnë në zonën e punëtorisë për prodhim në shkallë më të gjerë ose seri të vogla. Gjithashtu, FabLab-i do të shërbejë si vend ekspozimi për mostra të

HAPËSIRAT




FIG.4 STUDIO PROJEKTIMI. IMAZH.




FIG.5 SALLA E EVENTEVE. IMAZH.



FIG.6 FAB-LAB. RAST STUDIMOR

krijua më herët, duke pasqyruar rrjedhën dhe zhvillimin e ideve me vlerë mësimore. Pajisje si lazerë prerës, printerë 3D, si edhe makina të programueshme dhe të automatizuara, përbëjnë elemente kyçe të kësaj hapësire. Bashkëpunimi me disiplina të tjera, veçanërisht informatikën dhe elektroteknikën, konsiderohet i rëndësishëm për zhvillimin e modeleve të ndërlikuara dhe ndërvepruese.

Në sens mobilimi karakterizohet nga rafte të mëdha që mund të magazinojnë paisjet e shumta dhe nga tavolina të lëvizshme që ofrojnë fleksibilitet në hapjen e hapësirës.

1.7 DEPO

Në skajin e majtë të objektit një katësh në katin 0 gjendet një depo magazinimi me rafte metalike perimetrale dhe qendrore.




FIG.7 FRAGMENT I DEPOS NË PLAN.




FIG.8 PLANIMETRIA E KATIT 1

2.1 ZYRA E KONFERENCAVE SMART

Salla e Konferencave Smart është një ambient bashkëkohor dhe i pajisur me teknologji të avancuar, i projektuar për të mbështetur prezantime, seminare, takime strategjike dhe evente akademike, përmes përdorimit të sistemeve digjitale interaktive. Në aspektin planimetrik, hapësira është e organizuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, me korridore të gjera dhe të lehta për qarkullim. Mobilimi është i strukturuar sipas një rreshtimi ortogonal që favorizon orientimin dhe funksionin.



FIG.9 SMART CONFERENCE. IMAZH.

Salla është e pajisur me teknologji moderne, përfshirë: një sistem të avancuar audio-video me monitorim të vazhdueshëm, ndriçim dhe akustikë të përshtatshme në mënyrë automatike, tabela interaktive, mjete për realitet të zgjeruar (AR/VR), si edhe një sistem të automatizuar për menaxhimin dhe rezervimin e hapësirës.

2.2 ZONA E PROJEKTIMIT TË SISTEMEVE SMART DHE ZONA E TESTIMIT TË SISTEMEVE INTELIGJENTE.

Ky ambient do të jetë i dedikuar për modelimin dhe kodimin e sistemeve inteligjente për ndërtim dhe menaxhim urban. Hapësira është e organizuar në mënyrë të rregullt me stacione përkatëse për programimin, montimin, prodhimin dhe testimin elektro-magnetik.



FIG.10 CONTROL ROOM. IMAZH.

Mobiljet

3. Recepsioni 150x70x110cm
4. Karrige recepsioni
5. Tavoline ekspozimi holl 1 417x70x45-82cm
6. Tavoline ekspozimi holl 2 695x70x45-82cm
7. Tavoline ekspozimi holl 3 150x70x82cm
8. Tavoline ekspozimi holl 4 450x70x82cm
9. Raft+panelet ekspozimi 1 560x60x366cm
10. Raft+panel3 ekspozimi 2 50x60x342cm
11. Panelet ekspozimi 403x50x311-344cm
12. Skelet metali per ekspozim 444x10x344cm
13. Raft druri 1 150x50x344
14. Raft druri 2 50x50x344
15. Raft i ulet druri 1 477x50x150cm
16. Raft i ulet druri 2 120x50x150cm
18. Raft druri 4 100x50x344cm
19. Raft druri 5 145x50x344cm
20. Tavoline pune e bardhe 140x70x73cm
21. Karrige studio
24. Divan 160x80
25. Raft i ulet druri 2 160x60x150cm
26. Tavoline mesi 1
27. Tavoline mesi 2
28. Kolltuk
29. Karrige 1
32. Karrige 2
33. Tavoline SMART 65" e rrethuar nga plan pune druri
37. Karrige zyre
38. Tavoline pune 1 450x57x73cm
39. Panel mbyllje me dru 450x344cm
40. Raft druri 6 250x50x344cm
- 40.1 Raft druri 125x50x344cm
41. Tavoline pune 2 145x160x150cm
42. Tavoline pune 3 (e levizshme) 205x75x73cm
43. Tavoline gjysme-rreth druri 100x243x73cm
44. Raft druri 7 + plan pune
45. Raft druri 8 340x50x344cm
46. Raft druri 9 145x50x344cm
47. Raft druri 10 250x50x344
48. Raft druri 11 + plan pune 560x60x344cm
49. Raft druri 12 370x60x344cm
50. Raft druri 13 260x90x344cm
51. Raft druri 14
54. Karrige salle evente + tavoline dore, stackable
82. Tavoline e levizshme anti-vibrim
91. Tavoline pune e mbyllshme
97. Tavoline pune e levizshme ESD (ElectroStatic Discharge)
98. Tavoline pune 8 (Smart Lab) 1040x80x73
99. Raft druri 28 145x50x323
100. Raft druri 29 250x50x323
101. Raft druri 30 555x60x323
102. Raft druri 31 260x60x323
103. Raft druri 32 250x50x323
104. Raft druri 33 740x38x323
167. Tavoline pune (SMART Lab)

FIG.11 LISTA E MOBILJEVE.

Projekti i mobilimit ndahet në mobilie të prodhuara dhe pajisje të lëvizshme. Pjesa e mobilimit përbën një pjesë të konsiderueshme të vëllimit të punës. Mobiliet janë ndërtuar kryesisht me panele multistrat, elementë përforcues metalikë të mbrojtur nga oksidimi, të llakuar duke ruajtur teksturën natyrore të drurit ose të lyer sipas RAL-it të specifikuar për secilën mobilje. Gjithashtu, specifikohen edhe ngjyra dhe antioksidanti i aplikuar në sipërfaqet metalike të mobilieve.

Mobilimi duhet të jetë i thjeshtë për t'u instaluar dhe të mund të ndërtohet, mirëmbahen, përshtatet apo riparohet nga vetë përdoruesit.

Materiali kryesor i përzgjedhur do të jenë panelet e drurit multistrat — panele të përbëra, të ndërtuara me disa shtresa druri të ngjitura në mënyrë të kryqëzuar, të dizajnuara për të ofruar forcë, stabilitet dhe shumëllojshmëri në të gjitha aplikimet e mobilimit. Këto panele do të përdoren gjerësisht për elementët strukturalë, sipërfaqe, mbyllje, raftet dhe përbërës mbështetës.

MULTISTRATI

Panelet do të përbëhen nga disa shtresa furniere druri të butë ose të fortë, të vendosura në mënyrë të alternuar dhe të ngjitura nën presion të lartë me adezivë rezistentë ndaj lagështirës. Një ndërtim tipik do të përfshijë 7 deri në 9 shtresa, në varësi të materialit të bërthamës, duke garantuar qëndrueshmëri dimensionale të lartë dhe kapacitet të mirë mbajtës. Trashësia standarde për këtë projekt do të jetë 20

mm (± 0.5 mm në varësi të tolerancave dhe situatës për secilën mobilje), duke ofruar një ekuilibër të mirë ndërmjet forcës strukturore dhe peshës së përshtatshme për montim dhe trajtim.

ELEMENTËT METALIKË

Elementet metalike do të shërbejnë si përbërës strukturorë dhe dekorativë, dhe do të përdoren për këmbë, korniza, përforcime, mbajtëse, doreza, elemente zburkuese dhe pjesë të ekspozuara. Të gjitha pjesët duhet të plotësojnë kërkesat për forcë mekanike, cilësi estetike dhe rezistencë ndaj konsumit dhe oksidimit, veçanërisht në ambiente të brendshme me lagështi të ndryshueshme dhe përdorim të përditshëm.

Të gjitha pjesët metalike do të prodhohen nga çelik ose alumin cilësor, të përzgjedhur sipas nevojës së aplikimit specifik, peshës dhe performancës mekanike.

KORROZIONI

Të gjithë elementët metalikë të mobilimit do t'i nënshtrohen trajtimeve sipërfaqësore antikorrozive për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë dhe ruajtje të cilësive estetike. Përbërësit do të galvanizohen me zink ose do të prodhohen prej çeliku inox, në varësi të funksionit të tyre, për të siguruar mbrojtje maksimale ndaj oksidimit në kushte të ndryshme mjedisore. Për elementët e ekspozuar në ambiente me lagështi të lartë ose afër dritareve dhe dyerve të jashtme, do të përdoren veshje me pluhur elektrostatisht, të kombinuara me përfundime sipërfaqësore në përputhje me kodet RAL të projektit.

PËRSHTATJA E MOBILIMIT SIPAS NEVOJAVE TË MAGAZINIMIT

Mobilimi është projektuar në mënyrë të tillë që të përgjigjet ndaj nevojave të ndryshme të magazinimit, përmes përdorimit të moduleve të ndryshëm funksionalë. Rafte të hapura, kabine me mbyllje, sirtarë të integruar dhe njësi të lëvizshme do të përdoren për të optimizuar hapësirat, duke u përshtatur me funksionalitetin e çdo zone. Struktura modulare dhe dimensionimi fleksibël i mobiljeve siguron kapacitet të mjaftueshëm magazinimi në funksion të ruajtjes së materialeve, veglave të punës apo dokumentacionit, pa kompromentuar estetikën apo qarkullimin në hapësirë.

MOBILIMI NË FASADË




FIG.12 MOBILIMI NË FASADË

Në rastet ku mobilimi ndërvepron drejtpërdrejt me elementët e fasadës, ai do të projektohet në harmoni me strukturën ekzistuese dhe karakteristikat arkitektonike të ndërtesës. Për mobiljet që vendosen pranë dritareve ose mureve të jashtme, do të parashikohen masa teknike për mbrojtje ndaj lagështirës, rrezatimit diellor dhe ndryshimeve termike. Për më tepër, materiali i përdorur, përfundimet sipërfaqësore dhe mënyra e fiksimit do të sigurojnë që mobilimi të mos dëmtojë fasadën ekzistuese, por të integrohet vizualisht dhe funksionalisht me të.

PËRSHTATJA E MOBILJEVE ME RRJETIN ELEKTRIK DHE DALJEN E PRIZAVE

Projektimi i mobilieve do të marrë parasysh vendndodhjen dhe funksionalitetin e rrjetit elektrik, duke përfshirë integrimin e kanalizimeve elektrike, prizave dhe daljeve të tjera funksionale brenda strukturës së mobiljes. Njësitë e punës dhe tavolinat do të pajisen me akses të drejtpërdrejtë në energji elektrike, përmes kanaleve të fshehura ose kutive teknike të integruara, që sigurojnë përdorim të sigurt dhe estetik. Kjo zgjidhje ndihmon në organizimin e kabllave, shmang rrëmujën vizuale dhe rrit efikasitetin e përdoruesve në hapësirat e përbashkëta apo ato të punës individuale.

PËRSHTATJA E MOBILIMIT ME SITUATËN EKZISTUESE TË HVAC

Për të mos penguar funksionimin e sistemit ekzistues të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit (HVAC), mobilimi do të projektohet në përputhje me pozicionet e kanaleve të ajrit, difuzorëve dhe grilave të sistemit. Hapësirat e nevojshme për qarkullimin e ajrit do të parashikohen në detaje, duke shmangur mbulimin apo bllokimin e pikave të shpërndarjes. Mobiljet pranë këtyre elementëve do të kenë ndarje të përshtatura ose lartësi të kontrolluar, për të ruajtur performancën termike dhe ventilimin natyror, pa ndikuar në komoditetin e përdoruesve dhe funksionalitetin e përgjithshëm të sistemit HVAC.

VERIFIKIMI I AFTËSISË MBAJTËSE DHE QËNDRUESHMËRISË SË MOBILIMIT

Të gjitha elementët e mobilimit do t'i nënshtrohen një procesi verifikimi për aftësinë mbajtëse dhe qëndrueshmërinë e tyre, në përputhje me përdorimin e parashikuar dhe standardet teknike përkatëse. Kjo përfshin testimin e stabilitetit, kapacitetit të ngarkesës, si dhe rezistencën ndaj konsumit në kohë, për të garantuar funksionalitet dhe jetëgjatësi të produkteve.

PRODHIMET ME MATERIAL MULTISTRAT ME BAZË LOKALE

Materiali bazë për mobilimin do të jetë paneli multistrat i prodhuar nga lëndë drusore të burimeve lokale. Kjo zgjedhje synon të reduktojë ndikimin mjedisor, të mbështesë ekonominë vendase dhe të sigurojë përpunim më të lehtë dhe afat më të shkurtër furnizimi. Panelet do të kenë cilësi të certifikuar, të përshtatshme për përdorim në mobilje strukturore dhe dekorative.

PAJISJE DHE MOBILJE SPECIFIKE ME POROSI NGA KONTRAKTORI

Për elementët e mobilimit dhe pajisjet që kërkojnë dimensione ose funksione të veçanta, prodhimi do të kryhet me porosi nga kontraktori i përzgjedhur. Këto njësi do të projektohen në përputhje me kërkesat specifike të projektit dhe do të realizohen sipas detajeve të dakordësuara në fazën e zbatimit, duke garantuar përshtatshmëri të plotë me hapësirat përkatëse dhe funksionin që mbulojnë.

MOBILJE TË LËVIZSHME DHE TË PALËVIZSHME (STATIKE)

Në projektimin dhe organizimin e hapësirave, mobiljet ndahen kryesisht në dy kategori kryesore: të lëvizshme dhe statike. Mobiljet e lëvizshme janë ato që mund të ndryshojnë vendndodhjen lehtësisht, duke ofruar fleksibilitet dhe përshtatje të shpejtë sipas nevojave të përdoruesve dhe funksioneve të ndryshme të hapësirës. Këto përfshijnë tavolina, karrige, rafta me rrota apo elementë modularë që mund të montohen dhe çmontohen lehtësisht. Ndërkohë, mobiljet statike janë të vendosura në mënyrë të përhershme ose semi-permanente dhe luajnë një rol themelor në strukturën dhe funksionimin e hapësirës, si p.sh. tavolina të integruara, dollapë të ngulitur dhe struktura që nuk parashikojnë zhvendosje të shpeshtë. Ndërtimi dhe materiali i këtyre dy llojeve të mobiljeve ndryshojnë shpesh në bazë të qëllimit, qëndrueshmërisë dhe nevojës për adaptim, duke siguruar një balancë optimale mes qëndrueshmërisë dhe fleksibilitetit në përdorim. Përzgjedhja e duhur e mobiljeve të lëvizshme dhe statike ndihmon në krijimin e një ambienti funksional dhe efikas, i cili mund të përshtatet lehtësisht me ndryshimet e programeve dhe kërkesave të përdoruesve.




FIG.13 AKSONOMETRI. MOBILJE E LËVIZSHME.
NR.41




FIG.14 VIZATIM TEKNIK. PANELE TË PALOSSHME.
NR. 39

ARCHISPACE + iRI

2025